



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr. 380 prot., i AK, datë 25.08.2021 “Njoftim përqendrimi i garantuar”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A nga shoqëria Fideuram – Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Referuar “Marrëveshjes për blerjen dhe transferimin e aksioneve në lidhje me Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A.”, palët janë:

Blerësi: Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A është një shoqëri aksionere, e themeluar sipas legjisllacionin italian. Ajo i përket Grupit Financiar Intesa Sanpaolo dhe është e specializuar në ofrimin e shërbimeve këshilluese financiare.

Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri përmes filialit të zotëruar tërësisht prej tij Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA.

Shitësi: Quilvest Wealth Management S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me objekt aktiviteti ofrimin e zgjidhjeve të personalizuara të menaxhimit të pasurive dhe zyrave familjare.

Shoqëria zotërohet nga shoqëritë Quilvest S.A. dhe Vauban Participations S.A.

Target: Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, aktivitetet e së cilës kanë të bëjnë me investimet dhe shërbimet bankare, shërbimet e menaxhimit të pasurisë si dhe të gjitha aktivitetet e tjera që mund të kryejë një institucion krediti.

Compagnie de Banque Privee Quilvest S.A. nuk është aktive dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i

kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.